

NGJITËS & RRAFSHUES



ECOLINER

Ngjyra	Paketimi	Konsumi si ngjitës
E bardhë	25 KG	2-3kg/m ²

PËRSHKRIM

Kollë rrafshuese me bazë çimento të bardhë, nivelues dhe rrafshues për pllaka izolimi termik (EPS), si dhe mbi suva mbushëse me bazë çimento-gëlqere, për fasadë dhe xokolaturë. Gëzon aftësi shumë të mira në punim dhe rezistencë të lartë kundra lagështirës. Trashësia maksimale e shtresës deri në 3mm.

FUSHA E APLIKIMIT


Për rrafshimin e të gjitha tipeve të pllakave të izolimit termik, për veshje fasadash dhe xokolaturash. I përshtatshëm dhe për përforcimin e bazamenteve minerale për veshje të mëvonshme dekorative.

PËRGATITJA E BAZAMENTIT

Bazamenti duhet të jetë i pastër pa pluhura, vajra apo mbetje të cilat bëhen pengesë në lidhjen midis shtresave. Pastrimi i bazamentit bëhet në mënyrë mekanike ose manuale. Për bazamente që nuk janë të qëndrueshëm është e domosdoshme vendosja e kunjave fiksuese. Koha e punueshmërisë së përzieries është 2-3 orë. Në kushte normale temperaturash (20° C).




APLIKIMI

Përzieni me një përzieries elektrik 6-6.5 litra ujë me një thes 25kg Ecoliner në një enë të pastër, derisa të arrihet një masë homogjene dhe pa kokrriza. Përpara nivelimit të sipërfaqes me koll vendosni kunjat fiksuese në varësi të pllakës së vendosur 5-6 kunj/m². Aplikoni produktin me mall mbi pllakën izoluese në një trashësi prej 3mm. Për sistemin e termoizolimit aplikoni rrjetën përforcuese në mënyrë që të zhytet në ngjitës. Në kënde apo në vendet e bashkimit në dyer apo dritare është e nevojshme që të aplikohet dy herë rrjeta përforcuese. Temperaturat optimale të punimit janë nga 5°C deri në 35°C. Për veshjet e mëvonshme është e rëndësishme që bazamenti të ketë arritur maturimin në tharje rreth 5-7 ditë kjo varet nga kushtet atmosferike.



TË DHËNAT TEKNIKE

Pamja: Pluhur	Masa Vëllimore: 1.6-1.7 gr/cm ³
Paketimi: Thes letre 25 kg në paleta 1350kg	Ujë për përzierjen: 6-6.5 litra ujë për 25 kg
Ngjyra: E bardhë	pH i perzierjes: >12
Kokrrizimi: 0.7 mm	Temperatura e aplikimit: +5°C deri në +35°C
Konsumi si ngjitës: 2-3 kg/m ²	Rezistenca ne shtypje: 10N/mm ²
Magazinimi: Të ruhet në vende të thata mbi paleta druri	Reaksioni ndaj zjarrit: Klasa A1
Koha e Magazinimit: 12 muaj nga data e prodhimit	



KUJDESI! Si temperaturat e ulta dhe temperaturat e larta mund të ndryshojnë karakteristikat e punimit të produktit (ngadalsim ose përsheptim në tharje të produktit). Mos e përdorni në:

- Suporte druri,metali, PVC apo sipërfaqe të tjera jo me bazë çimento.
- Në ambiente ku ka lagështirë të vazhdueshme,
- Suporte që karakterizohen nga vibrime të paqëndrueshme.
- Në temperatura të larta, të ulëta, me erë të fortë.